

RREGULLORE
“PËR PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR KUFIZIMIN E PËRHAPJES
SË COVID-19



**GJATË USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR
TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE”**

Tiranë, 2020

Neni 1

Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet dhe miratohet në bazë të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nenit 42 të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, ligjit nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, Urdhrit nr.156, datë 10.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe në zbatim të Urdhrit të Komisionerit nr. 64, datë 12.03.2020 “Për marrjen e masave organizative dhe administrative nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në kuadër të parandalimit të përhapjes së Covid – 19”.

Neni 2

Objekti

Objekti i kësaj rregullore është përcaktimi i rregullave dhe praktikave të duhura, nisur nga situata në të cilën ndodhet vendi për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga COVID-19, për kufizimin e përhapjes së këtij infeksioni, duke mbikëqyrur zbatimin e planit të masave organizative dhe administrative, gjatë veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”).

Neni 3

Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. Pandemia, është përhapje e një sëmundjeje të re në shkallë botërore duke shfaqur epidemi në shtete të shumta dhe kontinente në të njëjtën kohë;
2. Sëmundja koronavirus 2019 (COVID-19), është një sëmundje infektive e shkaktuar nga sindromi i rëndë akut i frymëmarrjes koronavirus 2 (SARS-CoV-2);
3. Struktura Përgjegjëse, është Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës;
4. NJVKSH, është Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor në Qarkun e Tiranës;
5. ISHP, është Instituti i Shëndetit Publik.

Neni 4

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë dhe orientojë punonjësit mbi:

1. Reduktimin e transmetimit dhe parandalimit të përhapjes së infeksionit COVID-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit.

Rregullore “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së COVID-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit”

2. Sigurimin e një ambjenti të shëndetshëm në punë të punonjësve të Zyrës së Komisionerit. Vijimësinë normale të veprimtarisë së institucionit në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik.

Neni 5

Organizimi i punës në institucion gjatë periudhës së gjëndjes së pandemisë COVID-19

1. Gjatë periudhës së gjëndjes së pandemisë, Zyra e Komisionerit realizon veprimtarinë e saj nëpërmjet kombinimit të punës në ambientet e institucionit dhe sipas rastit mund të vlerësohet edhe puna në distancë.
2. Nëpunësit/punonjësit e Zyrës së Komisionerit të cilët nuk kanë përgjegjësi të tyre ofrimin e shërbimeve dhe për të cilët nuk është e nevojshme prania në institucion, sipas rastit vlerësohet që të punojnë në distancë duke u mbështetur në detyrat funksionale nga eprori përkatës dhe specialisti IT.
3. Për nëpunësit/punonjësit që punojnë në ambientet e institucionit, duhet të merret parasysh respektimi i largësisë prej 2 metrash ndërmjet nëpunësve.

Neni 6

Ofrimi i shërbimeve ndaj publikut

1. Zyra e Komisionerit duhet të garantojë veprimtarinë e saj gjatë gjëndjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, duke ofruar masa për të minimizuar kontaktin midis qytetarëve dhe nëpunësve/punonjësve dhe për të shmangur grumbullimin e tyre në ambientet pritëse apo në ambiente të tjera të brendshme duke siguruar ventilimin/ajrimin e shpeshtë.
2. Masat duhet të përfshijnë rastet e ofrimit të shërbimeve online, duke shfrytëzuar përdorimin e mjeteve të komunikimit elektronik për të nxitur qytetarët të përdorin platformat online të ofrimit të shërbimeve apo marrjes së informacionit, etj.
3. Për ushtrimin e veprimtarisë për të cilat nevojitet kontakt i drejtpërdrejtë me publikun, Zyra e Komisionerit duhet të pajisë nëpunësit/punonjësit me mjete punë mbrojtëse dhe të vendosë sinjalistikën e nevojshme.

Neni 7

Puna në terren

Nëpunësit/inspektorët/punonjësit e Zyrës së Komisionerit duhet të respektojnë rregullat e distancimit fizik dhe të përdorin mjetet mbrojtëse gjatë punës në terren.

Neni 8

Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për punën online

1. Zyra e Komisionerit duhet të nxisë dhe përmirësojë përdorimin e mjeteve në funksion të punës online, duke identifikuar metoda të thjeshta për përdorim nga të gjithë nëpunësit, në varësi të llojit të detyrave që ata duhet të përmbushin.
2. Me qëllim respektimin e distancimit fizik, por edhe rritjen e produktivitetit gjatë punës, Zyra e Komisionerit duhet të përdor mjetet e punës online, si:
 - e-mail zyrtar, i cili mund të konfigurohet për t'u përdorur në telefon ose edhe në web;
 - programe ose shërbime që lejon ruajtjen dhe organizimin e dokumentave, ndarjen e tyre me nëpunësve të tjerë online (Microsoft OneDrive);
 - Aplikacione që sigurojnë aksesimin në distancë të dokumenteve në kompjuterin e punës (AnyDesk, TeamViewer);
 - Platformat që mundësojnë komunikimin në kohë reale, organizimin e video konferencave në mënyrë që nëpunësit/punonjësit të komunikojnë me njëri-tjetrin (Cisco Webex Meetings).
3. Për të garantuar një përdorim sa më efektiv të mjeteve të punës online, nëpunësit e njësive të TIK duhet të sigurojnë instalimin e tyre dhe informacionin e nevojshëm për përdorim nga ana e të gjithë nëpunësve. Ky informacion mund të përcillet përmes e-mailit.

Neni 9

Minimizimi i riskut të infektimit nga COVID-19 gjatë mbledhjeve ose seancave dëgjimore

1. Nëpunësit/punonjësit brenda Zyrës së Komisionerit udhëzohen t'i zhvillojnë mbledhjet e tyre ose aktivitetet e tjera të kësaj natyre, të tilla si: konferenca, seminare, trajnime profesionale, seanca dëgjimore etj, duke përdorur platformat e komunikimit online (Cisco Webex Meetings).
2. Nëse vlerësohet organizimi i takimit apo seancës dëgjimore në mjediset e Zyrës së Komisionerit, duhet të merren masat e nevojshme për minimizimin e rrezikut të infektimit nga COVID-19.

Neni 10

Masat e përgjithshme të higjienës dhe të distancimit social në institucion

1. Në ambientet e Zyrës së Komisionerit duhet të sigurohet në mënyrë të vazhdueshme përdorimi i produkteve të higjienës, ku përfshihen sapun i duarve, dezinfektantët me bazë alkooli që kanë të paktën 70% alkool, letër apo peceta për pastrimin e duarve, letra dhe dezinfektantë për pastrimin e sipërfaqeve. Koshat për hedhjen e mbeturinave në çdo zyrë duhet të pajisen me qese të cilat duhet të ndërrohen përditë në përfundim të ditës së punës.
2. Punonjësit duhet t'i sigurohet në mënyrë të vazhdueshme pajisja me mjetet mbrojtëse personale si maska dhe doreza njëpërdorimshe, të cilat duhet të ndërrohen çdo ditë.

Rregullore *“Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së COVID-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit”*

Përdorimi i maskave dhe dorezave shërben si barrierë fizike për minimizimin/kufizimin e transmetimit të infeksionit COVID-19.

3. Në ambientet e punës duhet të praktikohet pastrimi i vazhdueshëm i korridoreve, sipërfaqeve dhe elementëve të tjerë të vendit të punës si p.sh: tavolinat e punës, tastierat, telefonat, parmakët dhe dorezat. Produktet dezinfektante që përdoren për pastrim, të kenë përqindjen e alkoolit sipas pikës 1 të këtij neni, metodën e aplikimit dhe kohën e kontaktit të saktë si dhe përdorimi i tyre duhet bërë duke përdorur mjetet e mbrojtjes personale (*mbështetur në Udhëzuesin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për pastrimin e mjedisit në objektet jo të kujdesit shëndetësor, e ekspozuar ndaj COVID-19*);
4. Tualetet duhet pastruar dhe dezinfektuar në mënyrë të vazhdueshme;
5. Për shmangien e përhapjes së infeksionit në ambientet e punës së Zyrës së Komisionerit nga persona që nuk janë pjesë e stafit të institucionit, në ambientin hyrës duhet të vendoset dezinfektant me bazë alkooli që përmban të paktën 70% alkool, i dedikuar vetëm për këta persona. Përdorimi i tij është i detyrueshëm për të patur akses në ambientet e tjera.
6. Çdo qytetar që futet në ambientet e institucionit duhet të jetë i pajisur me mjetet mbrojtëse personale si maska dhe doreza njëpërdorimshe.

Neni 11

Detyrimet e strukturës përgjegjëse

1. Struktura përgjegjëse, për krijimin e kushteve dhe monitorimin e zbatimit të kësaj Rregulloreje, është Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës.
2. Struktura përgjegjëse duhet të vendosë në një vend të përshtatshëm dhe të dallueshëm në ambientin hyrës, në çdo kat, si dhe në ambientet e përbashkëta, postera udhëzues që inkurajojnë higjienën për të ndihmuar në ndalimin e përhapjes së infeksionit.
3. Struktura përgjegjëse duhet të parashikojë një plan masash për të siguruar distancimin social.
4. Struktura përgjegjëse, përpara se të hyjë në institucion çdo punonjës apo qytetar, duhet të kontrollojë temperaturën me anë të termometrave të posaçëm për matjen në distancë dhe më pas të lejohet ose jo hyrja në institucion.
5. Struktura përgjegjëse për aq sa është e mundur duhet të përmirësojë kontrollet inxhinierike duke përdorur sistemin e ventilimit të ndërtesave. Kjo mund të përfshijë disa ose të gjitha aktivitetet e mëposhtme:
 - a. Rritjen e niveleve të ventilimit;
 - b. Rritjen e përqindjes së ajrit në natyrë që qarkullon në system

Neni 12

Detyrimet e punonjësit

1. Nëpunësit/punonjësit, me qëllim ruajtjen e shëndetit vetjak dhe të kolegëve, duhet të kujdesen që të zbatojnë me përpikmëri të gjitha rregullat e parashikuara në këtë rregullore.
2. Nëse në institucion një nga nëpunësit/punonjësit është apo ka pasur kontakt të ngushtë me një person pozitiv me COVID-19, ai duhet të qëndrojë në vetëkarantinim dhe të njoftojë mjekun e familjes dhe drejtuesin e institucionit.
3. Punonjësi që shfaq shenja klinike duhet të qëndrojë në shtëpi, apo të largohet menjehere nga ambientet e punës, të vetëkarantinohet, të njoftojë eprorin direkt, të monitorojë shenjat klinike dhe për çdo shqetësim të njoftojë në numrin 127 të urgjencës mjekësore ose mjekun e familjes dhe të paraqesë dokumentin e lëshuar nga ky i fundit për ditën në fjalë.
4. Në rast të vijimit të simptomave apo çdo diagnoze tjetër, pajiset me raport, apo deponon kërkesën për leje pa të drejtë page.
5. Punonjësi duhet të përdorë mjetet e mbrojtjes personale si maska dhe doreza si dhe duhet të lajë shpesh duart me ujë dhe sapun ose pastrojë ato duke i fërkuar me pastrues me bazë alkooli (*me përqindjen e alkoolit siç është përcaktuar në nenin 10 të kësaj rregulloreje*).
6. Maska duhet të vendoset në mënyrë të tillë që të mbulojë plotësisht fytyrën nga maja e hundës deri tek mjekra dhe duhet të hiqet duke e kapur vetëm tek pjesa e lidhëseve anësore dhe jo tek pjesa e përparme.
7. Punonjësi nuk duhet të përdorë shtrëngimin e duarve, por metoda të tjera jokontaktuese të përshëndetjes.
8. Punonjësi duhet të respektojë praktikën e etikës respiratore, kollitjes e tështitjes nëpërmjet vënies së gropëzës së bërrylit përpara gojës dhe hundës, ose shami letre. Shamia e letrës pas përdorimit duhet hedhur në koshin e mbeturinave dhe menjëherë më pas duhen larë duart.

Neni 13

Dispozitat e fundit

Dispozitat e kësaj rregulloreje janë të detyrueshme për zbatim nga i gjithë personeli i Zyrës së Komisionerit. Moszbatimi i saj sjell përgjegjësi disiplinore.

Ngarkohet për zbatimin e kësaj rregulloreje të gjithë punonjësit dhe Struktura Përgjegjëse në Zyrën e Komisionerit.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

Rregullore "Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së COVID-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Zyrës së Komisionerit"



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 419/prot
1

Tiranë më 24. 4 .2020

URDHËR

Nr. 73 , datë 23 . 4 2020

PËR

**“MIRATIMIN E RREGULLORES MBI PËRCAKTIMIN E MASAVE PËR
KUFIZIMIN E PËRHAPJES SË COVID-19 GJATË USHTRIMIT TË
VEPRIMTARISË SË ZYRËS SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHEMBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE”**

Në mbështetje të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nenit 42 të ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, Urdhrit nr.156, datë 10.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID - 19”, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Urdhrit të Komisionerit nr.64, datë 12.03.2020 “Për marrjen e masave organizative dhe administrative nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në kuadër të parandalimit të përhapjes së COVID - 19”,

URDHËROJ

1. Miratimin e “Rregullores për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së COVID-19 gjatë ushtrimit të veprimitarisë së Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij Urdhri.
2. Ngarkohen të gjithë nëpunësit/punonjësit e Zyrës së Komisionerit, për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

